



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.160/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Mitrovicë, në të cilën theksohet se më 03.10.2012, në bibliotekën e qytetit të Mitrovicës, anëtarët e subjektit politik LDK kanë vendosur posteret e kandidatit të këtij subjekti, pra në ndërtesën e bibliotekës. Me këtë rast LDK ka bërë shkelje të nenit 33 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nenit 3.4 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik LDK ka vendosur posterat e kandidatit të tyre në objektin e bibliotekës së qytetit të Mitrovicës, dhe se sipas tyre me këtë veprim kanë bërë shkelje të nenin 33 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nenit 3.4 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, PZAP-i i vlerëson si të pabazuara nga shkakut se nga fotografia nuk mund të shihet (vërtetohet) se objekti

konkret i cili shihet në fotografi është biblioteka e qytetit, andaj një pretendim i tillë i pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, nuk mund të konsiderohet i bazuar, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 160/2013 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes.*